

VENDIM
Nr.382, datë 14.6.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të pikës 2, dhe të paragrafit të parë të pikës 3, të nenit 9 dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shtetet e përcaktuara në lidhjen nr.8, "Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë", të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) "Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, me karta identiteti, duke paguar taksën e hyrjes:

Vendet anëtare të Bashkimit Europian, Britania e Madhe, Islanda, Norvegjia, San Marino, Zvicra, Australia, Kanadaja, SHBA-ja, Zelanda e Re."

b) Në listën "Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta), të shtohen shtetet:

"Andorra, Argjentina, Monako, Selia e Shenjtë, Singapor."

c) Pas kësaj pike, të shtohet një pikë tjetër, me këtë përmbajtje:

"Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me grupe turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike, të cilët më parë kanë mbërritur për qëllime vizite në vendet e rajonit me kufi tokësor me Republikën e Shqipërisë, duke marrë në kufi vizë të shkurtër kolektive 72-orëshe, kundrejt pagesës:

Bahreini, Bolivia, Brazili, Brunei, Ekuadori, Hong Kongu, Honduras, Guatemala, Kili, Kosta Rika, Meksika, Moldavia, Nikaragua, Panamaja, Paragvaj, Peruja, Rusia, Salvadori, Tailandë, Taivani, Ukraina, Uruguai, Venezuela, Xhamaika."

2. Pas pikës 7, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Kur agjencitë turistike organizojnë grupe turistike me turistë të huaj, nga vende, shtetasit e të cilave duhet të pajisen me vizë pranë përfaqësive, diplomatike ose konsullore, të Republikës së Shqipërisë dhe udhëtojnë drejtpërdrejt nga vendi i tyre për në Shqipëri, kërkesa për vizë, e bërë nga agjencitë turistike pranë këtyre përfaqësive do të trajtohet me procedurë të përshpejtuar. Procedurë të përshpejtuar në këtë rast, përbën trajtimi me përparësi i grupit, në kufijtë minimalë të kohës.

Agjencitë turistike të udhëtimit paraqesin pranë përfaqësive të Republikës së Shqipërisë listën emërore të anëtarëve të grupit turistik, ku të shënohen edhe shtetësia e numri i pasaportës, sipas formularit të dhënë nga përfaqësia, gjenealitetet e agjencisë turistike, të huaj, nëse një e tillë organizon udhëtimin e tyre në vendin e rezidencës së turistëve, si dhe programin e turit në Shqipëri."

3. Pas pikës 8, shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

"8/1. Grupet turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike, trajtohen me procedurë të përshpejtuar në kufi. Agjencitë turistike të udhëtimit paraqesin pranë drejtorisë vendore të policisë kërkesën zyrtare me vulë, të shoqëruar me listën emërore të anëtarëve të grupit turistik, ku është shënuar shtetësia dhe numri i pasaportës, sipas formularit të përcaktuar nga policia e kufirit dhe emigracionit, gjenealitetet e agjencisë turistike të huaj, nëse një e tillë bën shoqërimin e tyre deri në kufi, si dhe programin e turit në Shqipëri. Kjo listë i dërgohet drejtorisë vendore të policisë, si dhe pikës së kalimit të kufirit ku do të kryhet lëvizja, nëpërmjet fax-it ose e-mail-it, jo më vonë se 48 orë para mbërritjes së grupit, me qëllim marrjen e masave për regjistrimin paraprak të grupit turistik, i cili do të trajtohet me procedurë të përshpejtuar nga policia e pikës së kalimit kufitar, në çastin e mbërritjes.

Procedurë e përshpejtuar vlerësohet dhënia e vizës kolektive për rastet e caktuara në lidhjen nr.8 dhe/ose verifikimi vetëm i listës së grupit turistik, të paraqitur nga agjencia turistike, me praninë e turistëve

në autobus, dhe kontrolli i pasaportave, në çastin e mbërritjes në pikën e kalimit të kontrollit kufitar. Pas verifikimit të listës lejohet lëvizja e grupit turistik për të mos krijuar vonesë. Regjistrimi i turistëve bëhet në bazë të listës së dërguar më parë, jo në prani të grupit turistik.

Grupi turistik përbëhet prej jo më pak se dy personash, lista e të cilit deklarohet nga agjencia turistike.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha